



## **VENDIMI DHE GJETJET**

**Data e miratimit: 4 shkurt 2014**

**Numri i lëndës: 2012-14**

**Valbone Zahiti**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 4 shkurt 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PARA PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar në Panel më 27 shtator 2012.
2. Më 8 prill 2013, Paneli ka vendosur të njoftoj shëfën e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë, duke ftuar atë të dorëzojë vërejtje me shkrim rreth ankesës. Vërejtjet e ShM janë pranuar më 10 maj 2013. Më pas, ato i janë komunikuar ankueses për komente nga ajo. Ankuesja ka ofruar komentet e saj ndaj vërejtjeve të ShM më 30 maj 2013.

3. Më 20 maj 2013, Paneli ka ftuar ShM që t'i adresoj çështjet e tjera rreth pranueshmërisë, të cilat nuk ishin adresuar gjatë parashtrimit të tij të kaluar. Vërejtjet e ShM janë pranuar më 3 qershor 2013.
4. Në vendimin e tij të datës 7 qershor 2013, Paneli ka shpallur lëndën të pranueshme sa i përket shkeljeve të pohuara të nenit 8 në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe ka shtruar pyetje të mëtejshme për ShM dhe për ankuesen në mënyrë që të vendoset rreth bazueshmërisë së lëndës.
5. Më 1 gusht 2013, ankuesja ka parashtruar komente shtesë, të cilat më pas iu kanë dërguar ShM. ShM ka parashtruar vërejtje shtesë më 27 shtator 2013. Më pas ato iu kanë komunikuar ankueses për komentim. Ajo ka ofruar komente përfundimtare më 22 tetor 2013.

## II. FAKTET

Faktet vijuese janë vërtetuar në bazë të informatave që janë parashtruar nga palët:

6. Ankuesja pohon se më 7 qershor 2011 rreth orës 08:25, përderisa ishte duke kryer detyrat e saj zyrtare si police e Kosovës (PK) që siguron objektet e zyrës ndërlidhëse të Rumanisë, ishte sulmuar dhe lënduar nga një "zyrtar i EULEX-it", polic ndërkombëtar. Ajo pohon se ai qëllimisht kishte vozitur në drejtim të saj me makinën e tij, ku e kishte goditur atë me automjetin e tij dhe ia kishte lënduar këmbën e saj.
7. Ankuesja deklaron se incidenti ka ndodhur si pasojë e përpjekjes nga ana e atij anëtari të stafit të EULEX-it për t'u parkuar në mënyrë të paligjshëm. Anëtari i stafit të EULEX-it ishte përpjekur të parkonte automjetin e tij në një vend ku nuk lejohej, pra në një vend të rezervuar për zyrën ndërlidhëse të Rumanisë.
8. Dyshohet se ankuesja kishte paralajmëruar anëtarin e stafit të EULEX-it që mos të parkohej në këtë vend. Si përgjigje ky i fundit kishte fyer atë.
9. Situata ishte përkeqësuar aq sa zyrtari i EULEX-it kishte vozitur makinën e tij në drejtim të ankueses, ku e kishte goditur atë në këmbën e saj të djathtë. Ajo kishte urdhëruar atë ta ndalte makinën e tij, përderisa mbante armën e saj zyrtare dhe kërcënonte se do ta përdorte atë në vetëmbrojtje.
10. Ankuesja pohon se incidenti i ka shkaktuar lëndime, që kanë rezultuar me pasoja negative afatgjata për shëndetin e saj. Ajo nuk ishte në gjendje të kthehej në punë për gati tre muaj. Më tej, pohohet se ajo ende vuan nga probleme shëndetësore të vazhdueshme të shkaktuara nga ky incident. Pasi që natyra e punës së saj kërkon gjendje të mirë fizike, gjendja në të cilën ajo është tani rrezikon punën e saj

profesionale. Si pasojë, asaj i është dashur të merrte pushim mjekësor dhe pushime të tjera në kohë të ndryshme, që ka rrezikuar punën e saj.

11. Ankuesja i ka ofruar Panelit dokumentacion e vet mjekësor. Ajo deklaron se Policia e Kosovës nuk ofron sigurim shëndetësor, kështu që i është dashur t'i mbulonte të gjitha shpenzimet vetë. Ajo ka paraqitur një raport të përpiluar nga Policia e Kosovës, që përfshinë një raport të përkohshëm të EULEX-it, të shkruar nga pjesëtari i personelit të EULEX-it në fjalë, që është në kundërshtim me versionin e ankueses rreth ngjarjes. Sipas atij raporti, ankuesja ishte sjellë në mënyrë agresive ndaj tij. Si pasojë ai u largua me veturë nga vendi i incidentit. Në raportin e tij, ai nuk e përmend sulmin fizik.
12. Menjëherë pas incidentit, ankuesja është shoqëruar nga kolegët e saj të punës në stacionin qendror të policisë në Prishtinë, ku ajo ka marrë ndihmën e parë. Pas kësaj, ajo ka qenë nën kujdesin mjekësor në spitalin e Prishtinës. Kur ajo ishte në spital, një polic i EULEX-it kishte shprehur dëshirën për ta intervistuar atë në lidhje me incidentin. Ankuesja nuk kishte pranuar të intervistohet në atë fazë, pasi ajo nuk ndihej mjaft mirë. Ajo nuk ishte kontaktuar më nga EULEX-i.
13. Informata e dhënë nga ankuesja është vërtetuar nga raportet e EULEX-it të parashtruara në Panel. Nga ai bëhet e ditur se më 7 qershor 2011, një zyrtar policor i EULEX-it kishte ardhur në spital, ku hetues të Njësisë Rajonale për Krime (NjRK) ishin gati të merrnin një deklaratë nga ankuesja. Pas kthimit të saj në spital, ai zyrtar ishte informuar se ankuesja duhej t'i nënshtrohej testeve të mëtejme mjekësore dhe se ajo nuk do të jetë në gjendje të jap ndonjë deklaratë deri vonë pasdite. Në pasditen e të njëjtës ditë, zyrtari policor i EULEX-it ka shkuar në Njësinë e Hetimeve Rajonale, ku ajo ishte informuar se ankuesja ishte në rrugën e sipër për të dhënë deklaratën. Pas rreth 45 minutash, zyrtari policor i EULEX-it ishte informua se ankuesja nuk do të vinte në stacion, pasi ajo ende nuk ndihet mirë me shëndet. Zyrtari policor i EULEX-it ishte informuar nga hetuesit e NjRK-së se ajo do të kontaktohej në momentin kur ankuesja do të ishte në gjendje të jap deklaratën e saj, që ishte planifikuar për 8 qershor 2011.
14. EULEX-i ka pohuar se ankuesja ka dhënë një deklaratë për autoritetet e Kosovës më 8 qershor 2011. Megjithatë, pasi Policia e EULEX-it nuk ishte kontaktuar nga hetuesit e Kosovës, nuk kanë qenë i pranishëm asnjë përfaqësues i EULEX-it derisa merrej deklarata e ankueses. Një kopje e asaj deklarate iu ishte dorëzuar Njësinë për Sigurimin e Misioneve Diplomatike dhe më pas ishte marrë nga zyrtari i policisë së EULEX-it (përmendur më lartë, par. 13) atëherë kur ajo ishte kontaktuar nga hetues të PK-së rreth tre javë më vonë.
15. Më 7 qershor 2011, Njësia për Hetime të Brendshme e EULEX-it (NjHB) ka nisur një hetim të brendshëm rreth incidentit.
16. Më 8 qershor 2011, në përputhje me kodin e mirësjelljes së EULEX-it, udhëheqësi i kontingjentit i zyrtarit të EULEX-it i përfshirë në këtë

incident ishte informuar se ishte nisur një hetim i brendshëm. Më 30 qershor 2011, marrë parasysh se rezultati nga hetimet e brendshme ishte se pjesëtari në fjalë i EULEX-it kishte shkelur kodin e sjelljes, autoritetet shtetërore të anëtarit të EULEX-it kanë kërkuar që t'ia përfundojnë misionin dhe ta riatdhesonte atë.

17. Më 13 korrik 2011, NjHB-ja ka përfunduar raportin përfundimtar të të hetimit dhe ia kishte dorëzuar atë shefit të Misionit (ShM). ShM kishte vendosur ta mbyllte rastin, duke pasur parasysh vendimin e autoriteteve shtetërore që zyrtarin në fjalë ta riatdhesonte. Më 15 korrik 2011, ai ka kryer procedurat e tij të daljes nga puna dhe ai ishte riatdhesuar.
18. Në një datë të pasaktësuar të tetorit 2011, ankuesja ishte takuar me prokurorin publik të komunës së Prishtinës për t'u njoftuar lidhur me rastin e saj. Më 3 nëntor 2011, prokurori publik i kishte dërguar një letër ShM "me kërkesën që të vendoste për imunitetin" e zyrtarit të EULEX-it në fjalë.
19. Në përgjigje më 22 nëntor 2011, ShM ka informuar prokurorin lidhur me riatdhesimin e zyrtarit në fjalë dhe se misioni kishte mbyllur atë çështje. ShM po ashtu ka kërkuar sqarime nëse letra e prokurorit duhet të interpretohej si kërkesë për heqjen e imunitetit të atij zyrtari.
20. Më 4 maj 2012, EULEX-i ka marrë një përgjigje. Prokurori ka kërkuar heqjen e imunitetit, pasi zyrtari i EULEX-it dyshohej se kishte kryer veprën penale të "sulmit të personave gjatë kryerjes së detyrave zyrtare" e dënueshme sipas nenit 317 të Kodit Penal të Kosovës atëherë në fuqi.
21. Në përgjigjen e tij të datës 12 qershor 2012, ShM ka këshilluar prokurorin që autoritetet shtetërore të anëtarit në fjalë kishin kërkuar një kopje të dosjes së brendshme të EULEX-it me qëllim të shqyrtimit të saj. ShM ka ftuar prokurorin t'i kontaktoj autoritetet përmes kanaleve zyrtare për të vërtetuar nëse ka qenë duke u kryer ndonjë hetim prej autoriteteve shtetërore. Më tej thuhet se deri sa të sqarohet kjo pikë, ShM nuk është në gjendje të marrë ndonjë veprim të mëtejshëm në lidhje me heqjen e imunitetit. Autoritetet e Kosovës nuk kishin dërguar informacione apo komunikime të tjera tek EULEX-i në lidhje me këtë rast.

#### **LIGJI PËRKATËS NË FUQI**

22. Paneli është i autorizuar që t'i përdor instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Çështjet më të rëndësishme për punën e Panelin janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDKP), të cilat vendosin standardet minimale për

mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

### **Veprimi i përbashkët**

23. Pjesët përkatëse të shkëputura të nenit 2, 3 dhe 10, par. 2 i Veprimit të Përbashkët të Këshillit Evropian 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVË (më tutje: Veprimi i Përbashkët), thotë si më poshtë:

#### **Neni 2 Deklarata e Misionit**

EULEX-i në KOSOVË do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

EULEX-i në KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndihmë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

#### **Neni 3 Detyrat**

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në Nenin 2, EULEX-i në KOSOVË do të:

- (a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), përdërisa i ruan disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;
- (i) sigurojë që të gjitha veprimet e tij i përmbahen standardeve ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

#### **Neni 10 Statusi i EULEX-it dhe personeli i tij**

Shteti ose institucioni i BE-së që kanë rekrutuar personel është përgjegjës për t'iu përgjigjur çfarëdo pohimi, që ka të bëjë me punësimin, që vjen nga apo ka të bëjë me anëtar i stafit. Shteti apo institucioni i BE-së do të jetë përgjegjës për të ndërmarrë çfarëdo veprimi kundër personit të punësuar.

### **Ligji mbi kompetencat**

24. Ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (nr. 03/L-053, më tutje: Ligji mbi kompetencat) dhe më saktësisht neni i tij 17, i rregullon kompetencat ekzekutive të policisë së EULEX-it:

#### **Neni 17**

17.1 Gjatë kohëzgjatjes së EULEX-it KOSOVË në Kosovë, policia e EULEX-it do të ketë kompetencë të ushtrorë kompetencat siç njihen nga ligji i zbatueshëm për Policinë e Kosovës dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara nga shefi i EULEX-it në KOSOVË.

25. Paneli gjithashtu bazohet në Shtojcat G dhe J të Planit Operativ të EULEX-it, Kodit të Sjelljes dhe Disiplinës si dhe Procedurave Standarde të Operimit “mbi Hetimin e shkeljeve të pohuara të Kodit të Sjelljes dhe Disiplinës”.

## **Projekt nenet lidhur me përgjegjësinë e organizatave ndërkombëtare**

26. Për shkak të këtij vendimi, përmendet [projekt nenet lidhur me përgjegjësinë e organizatave ndërkombëtare](#), të miratuar nga Komisioni Juridik Ndërkombëtar në seancën e gjashtëdhjetë e tretë, në vitin 2011.

### **III. ANKESAT**

27. Ankuesja kërkon informacion në lidhje me statusin e lëndës së saj brenda EULEX-it dhe pranë gjykatave të shtetit prej nga vjen zyrtari. Ankuesja pohon se për shkak të imunitetit të personelit të misionit, ajo nuk ka pasur qasje në gjykatë që ishte kompetente për të përcaktuar të drejtat e saj në lidhje me dëmin të cilën ajo e ka pësuar. Më tej, ajo kërkon kompensim monetar për dëmin që pretendon se i është bërë shëndetit të saj, si pasojë e këtij incidenti.

### **IV. LIGJI**

28. Paneli rithekson se vendimi i pranueshmërisë së aplikacionit kishte konstatuar se lënda duhej të shqyrtohej sipas nenit 8 të KEDNj marrë së bashku me nenin 13 të së njëjtës Konvetë) shih 2012-14, [Zahiti kundër EULEX-it](#), 7 qershor 2013, në paragrafin 30).

### **Parashtrimet nga palët**

29. Në parashtrimin e datës 27 shtator 2013, EULEX-i jep shpjegime rreth pyetjeve që iu kanë bërë nga Paneli dhe ka paraqitur vërejtjet lidhur me meritat e ankesës.

### **Marrëdhënia e EULEX-it me ankuesen**

30. Lidhur me atë nëse ankuesja është njoftuar nga EULEX-i për rezultatet e procedurës disiplinore, gjetjet dhe/ose faktet e EULEX-it se zyrtari ishte riadhesuar në vendin e tij prej nga vinte, EULEX-i pohon se nuk është ngritur procedurë disiplinore lidhur me incidentin. Ishte zhvilluar një hetim i brendshëm, qëllimi i së cilës ishte që të vërtetojë faktet dhe vërtetësinë e akuzave. Masat disiplinore do të mund të merreshin vetëm pas gjetjeve dhe rekomandimeve të bëra në kontekst të një hetimi të tillë.
31. EULEX-i më tej pohon se nëse zyrtari nuk do të ishte riadhesuar me vendim të autoriteteve shtetërore të tij dhe nëse komisioni disiplinor do të ishte mbledhur, ShM do të ishte në gjendje që vetëm të rekomandojë masa disiplinore dhe t'ia komunikonte vendimin disiplinor autoriteteve shtetërore.
32. EULEX-i pohon se nuk ishte në pozitë që të informojë ankuesen për rezultatin e procedurës disiplinore, pasi procedura të tilla nuk ishin

nisur. Po ashtu nuk e ka informuar ankuesen për rezultatet e hetimeve të brendshme, sepse ajo nuk ishte palë aty. Hetimi i brendshëm u nxit nga raporti i bërë nga zyrtari në fjalë dhe nga njoftimi i EULEX-it për incidentit nga ana e autoriteteve të Kosovës. Ankuesja nuk iu kishte afruar drejtpërdrejt zyrtarit në fjalë e as nuk kishte parashtruar ndonjë ankesë zyrtare në EULEX. Ajo ishte ankuar vetëm tek autoritetet e Kosovës dhe më tek Paneli.

33. EULEX-i pohon se nuk ka obligim të informojë ankuesen për rezultatin e hetimeve të brendshme. Informacioni në lidhje me atë hetim ka qenë i kufizuar për personin në fjalë, mbikëqyrësin e tij të drejtpërdrejtë dhe autoritetet përkatëse shtetërore.
34. EULEX-i pranon se ishte kontaktuar nga prokurori i Kosovës. Kërkesa e prokurorit ishte “për të vendosur mbi imunitetin” e zyrtarit të EULEX-it të përmendur si “i dyshimtë” për “lëndime të lehta trupore”. Kjo kërkesë nuk ka përmendur ndonjë lëndim të rëndë ose sëmundje të përhershme apo edhe shpenzime mjekësore shkaktuar ankueses. Ajo nuk përmban asnjë kërkesë për të dhënë hollësitë e sigurimit të automjetit privat të zyrtarit të EULEX-it në mënyrë që të kërkohet kompensim.
35. Nëse EULEX-i kishte konsideruar ofrimin e një forme të kompensimit për ankuesen, edhe nëse jo, nëse do të ishte i gatshëm të merr në konsideratë këtë mundësi, EULEX-i i drejtohet rëndësisë së nenit 10 paragrafi 2 të Këshillit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP (shih par. 23 më lartë). Në rrethanat e lëndës në fjalë, EULEX-i nuk e ka konsideruar ofrimin e ndonjë kompensimi për ankuesen.

#### **Mundësia për t'u dëgjuar**

36. Në lidhje me pyetjen se nëse EULEX-i i ka dhënë ankueses mundësi që të dëgjohet në kuadër të hetimeve të brendshme disiplinore, EULEX-i ka përsëritur faktin se nuk është kryer asnjë procedurë disiplinore. Megjithatë, ajo i ka dhënë ankueses mundësinë që të dëgjohet në kuadër të hetimeve të brendshme.
37. EULEX-i pohon se NjHB-ja ka përfshirë në dosjen e vet deklaratën e bërë në PK-ja nga ankuesja më 8 qershor 2011 (shih par. 15 më sipër). EULEX-i më tutje pohon se sipas shefit të NjHB-së së EULEX-it, do të ishte e pëlqyeshme që të ishte i pranishëm një përfaqësues i EULEX-it përderisa të merrej deklaratata. Sidoqoftë, zyrtari policor i EULEX-it, i cili ishte përpjekur të kontaktonte ankuesen në atë ditë, nuk ishte kontaktuar nga hetuesit e PK-së deri tre javë më vonë, përkundër informacionit që ajo kishte dhënë më 7 qershor 2011 (shih par. 13 më sipër).

#### **Mjetet juridike në dispozicion**

38. Lidhur me atë se çfarë mjeti juridik ka qenë në dispozicion që ankuesja të kërkoj dhe të marrë dëmshpërblim, EULEX-i ka theksuar se nëse ajo do të kishte bërë kërkesë të vlefshme në lidhje me mbulimin e

shpenzimeve mjekësore dhe humbjes së mundshme të të ardhurave, ajo mund të kishte pasur të drejtë në mjetet juridike, përfshirë në udhëzimin e PK-së mbi parimet dhe procedurat që rregullon çështje të tilla. Pasi ajo ka pësuar lëndimin e pohuar gjatë kryerjes së detyrave të saj zyrtare, duhet që të zbatohen dispozitat përkatëse.

39. Në lidhje me ndonjë veprim të mundshme penal, EULEX-i sugjeron që prokurori i Kosovës ka vendosur që nuk do të ndërmerrej asnjë veprim i mëtejshëm i ndjekjes penale.
40. Në lidhje me një kërkesë të mundshme civile, EULEX-i në Kosovë nuk është në dijeni për ndonjë veprim civil të ndërmarrë nga ankuesja dhe sugjeron që dëmshpërblimi ka mundur të jetë kërkuar përmes një kërkesë parashtruar sigurimit.
41. Sa i përket veprimeve të mundshme nëpërmjet ambasadës së anëtarit të EULEX-it në Kosovë, EULEX-i thekson se ankuesja përmes parashtrimeve të saja të mëparshme në Panel ka përmendur po ashtu mundësinë për të pasur qasje në këtë mjet juridik.
42. Në lidhje me procedurat e EULEX-it për pretendimet e palëve të treta, EULEX-i deklaron se është i autorizuar për të konsideruar shqyrtimin e kërkesave të palës së tretë që dalin në lidhje me operacionet e tij. ShM ka kontraktuar një politikë të plotë të sigurimit, mbulimi i së cilës përfshinë detyrimin në lidhje me pretendimet e bëra nga palët e treta. Një kërkesë e arsyetuar, që është parashtruar në kohën e duhur mund të rezultojë në dhënien e kompensimit *ndër të tjera* për shpenzimet mjekësore, humbjen e të ardhurave dhe/ose humbjen e mbështetjes financiare, shpenzimet e transportit që lidhen me lëndim, sëmundje ose kujdes mjekësor dhe shpenzime ligjore dhe të varrimit që barten nga ankuesi. Asnjë kompensim nuk mund të paguhet për dëmet jo materiale të tilla si dhimbje dhe vuajtje apo ankthi shpirtëror. Po kështu, dëmet ndëshkuese nuk mund të paguhen. Çdo kërkesë e tillë e vlefshme duhet të adresohet tek ShM. Vendimet për kompensimin financiar varen nga bazueshmëria e kërkesës; në mënyrë të veçantë nëse parashtruesi i kërkesës ka pësuar dëm material të dukshëm.

#### **Komentet e mëtejshme lidhur me bazueshmërinë e lëndës**

43. Sa i përket nëse sjellja e pahijshme e anëtarit të EULEX-it ishte regjistruar nga EULEX-i në raportin për vlerësimin e punës së tij dhe/ose në ndonjë formë tjetër, EULEX-i tregon se kjo nuk ka ndodhur. Kjo do të kërkonte që të mblidhej Komisioni disiplinor (KD), që shqyrtimet e KD të konfirmoheshin, që të bëhej një raport që përcakton faktet dhe gjetjet përkatëse. Kodi i sjelljes dhe disiplinës përcakton se të gjitha vendimet për sanksionet e vendosura nga Këshilli disiplinor do të regjistrohen në dosjen e anëtarit të stafit. Kjo e dhënë mund të përdoret si bazë për mohimin e vazhdimin të kontratës së anëtarit të stafit. Megjithatë, siç u tha më lartë, asnjë procedurë disiplinore nuk ishte nisur për rastin në fjalë.



44. Sa i përket nëse EULEX-i ka diskutuar me autoritetet shtetërore mundësinë që shteti dërgues të ofroj kompensim dhe/apo dëmshpërblim për ankuesen, EULEX-i ka treguar se ato nuk e kanë bërë një gjë të tillë. ShM ka deklaruar se nuk është në gjendje për të hyrë në diskutime me autoritetet shtetërore pasi që çdo komunikim ndërmjet EULEX-it dhe shteteve anëtare duhet të kanalizohet nëpërmjet zyrës së Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS).
45. Sa i përket nëse EULEX-i ishte i informuar për secilin hap dhe masë të ndërmarrë nga autoritetet shtetërore të anëtarit në fjalë, EULEX-i ka deklaruar se nuk ka qenë i informuar rreth tyre.
46. EULEX-i më tej rithekson argumentet e veta, të cilat tashmë janë parashtruar në fazën e pranueshmërisë (shih 2012-14, [Zahiti kundër EULEX-it](#), 7 qershor 2013 par. 17 - 22). Atribuimi i veprimeve private të personelit EULEX-it do të vendoste një barrë joproporcionale mbi misionin, i cili punëson mbi 2000 zyrtarë, të cilët që të gjithë bashkëveprojnë me qytetarë, banorë dhe autoritete të Kosovës gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre ditore. EULEX-i më tej parashtron se neni 17 i Ligjit për Juridiksion autorizon policinë e EULEX-it për të ushtruar kompetencat e dhëna në Policinë e Kosovës me ligjet në fuqi dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara nga ShM. Modalitetet përkatëse janë të përcaktuara nga OPLAN sipas të cilit EULEX-i ndahet në divizionin Ekzekutiv dhe të Përforcimit. Zyrtarët e divizionit të këtij të fundit, si rregull i përgjithshëm, nuk kanë autorizim për të ushtruar kompetencat policore në Kosovë.

#### **EULEX-i në veprimet e mundshme ligjore kundër ankueses**

47. EULEX-i më tej parashtron se ishte ankuesja, si zyrtare e PK-së, ajo e cila vepronte në cilësinë zyrtare në ushtrimin e kompetencave që i janë besuar asaj si zyrtare e PK-së. Sjellja e saj gjatë incidentit ndoshta mund të konsiderohet *ultra vires* (përtej autorizimeve) ose si abuzim i autorizimit. EULEX-i, duke deklaruar se kjo nuk është punë e Misionit, vë në dukje se zyrtari i EULEX-it në fjalë apo autoritetet e tij shtetërore mund të parashtrojnë ankesë ndaj ankueses.

#### **Komentet e ankueses rreth parashtrimeve të ShM së datës 27 shtator 2013**

48. Me 22 tetor 2013 ankuesja i ka ofruar vërejtjet e saja rreth përgjigjes së ShM-së të datës 27 shtator 2013. Ajo ka paraqitur si më poshtë: *“Dëshiroj të shtoj se në lidhje me rastin unë gjithmonë kam qenë e hapur dhe unë jam e gatshëm të përballem me drejtësinë. Edhe pse komenti i shkruar nga EULEX-i nuk është kërcënim, unë e perceptojnë atë si kërcënim. (shih par. 47 më lartë) Unë do të jem e gatshëm të përballen me çfarëdo veprim ligjor të nisur kundër meje.”*

## Vlerësimi i Panelit

49. Paneli tashmë ka konstatuar se do të shqyrtojë lëndën në bazë të nenit 8 të KEDNj-së në lidhje me nenin 13 (shih par. 4 më lartë).

### i. Parashtrimet e EULEX-it në lidhje me sjelljen e supozuar të ankueses

50. Para se kthehemi në thelbin e ankesës, Paneli vëren me shqetësim parashtrimin e EULEX-it në lidhje me sjelljen e ankueses (shih par. 47 më lartë). Paneli vëren se EULEX-i ngrit mundësinë që pala e tretë mund të paraqes ankesë kundër saj.

51. Paneli vëren se ky lloj i parashtrimeve të EULEX-it nuk shton asgjë as në bazën faktike e as në argumentin ligjor përkatës lidhur me lëndën. Paneli mendon se ky lloj i parashtrimit mund të ketë efekt negativ të dekurajimit të ankuesve që mos t'i ndjekin pretendimet e tyre. Bazuar në këtë pikëpamje, Paneli i konsideron këto parashtrësia pavend.

### ii. Përgjegjësia e EULEX për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

52. Së pari, Paneli duhet të përcaktojë shtrirjen e juridiksionit të vet për qëllimin e lëndës në fjalë. Ai mund të shqyrtojë vetëm ankesat lidhur me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv, përfshirë veprimet e dyshuara nga ana e policisë së EULEX-it.

53. Paneli vënë re se janë parashtrimet e përgjithshme të EULEX-it në lidhje me të kuptuarit e tij se çfarë mund të përfshijë mandati i tij ekzekutiv (shih par. 46). Siç është theksuar edhe në raste të tjera pranë Panelit, EULEX-i pohon se zyrtarët e tij të policisë, sidomos ata që punojnë në kuadër të Divizionit të Përforsimit të Misionit, në përgjithësi nuk ushtrojnë asnjë fuqi ekzekutive.

54. Në këtë aspekt, Paneli thekson se tashmë ka konstatuar në vendimin e tij të pranueshmërinë se *“është e parëndësishme nëse [anëtari në fjalë i EULEX-it] ka punuar për një departament të veçantë në kuadër të EULEX-it apo në një tjetër. Kjo është çështje e organizimit të brendshëm që nuk mund të ndikojë në pretenduesit si palë e tretë”* (krahasoni [Zahiti kundër EULEX-it](#), 7 korrik 2013, në par. 35).

55. Paneli vëren se EULEX-i nuk ka siguruar bazë ligjore për sugjerimin e tij se “modalitetet e përcaktuara nga shefi i Misionit” (shih paragrafin 46 më lartë) i referohen atyre të përcaktuara nga OPLAN që ndan EULEX-in në divizionin ekzekutiv dhe divizionin e përforsimit. Paneli nuk është në dijeni të ndonjë kushti në OPLAN që do ta mbështeste një argument të tillë.

56. Paneli thekson se karakteri i EULEX-it si një misioni ndërkombëtar nuk duhet të barazohet me atë të një shteti, veçanërisht kur është fjala për detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Paneli në rastet e mëparshme

ka konstatuar se “duke pasur parasysh mandatin e kufizuar të EULEX-it, ai nuk mund të mbahen përgjegjës për dështimin që të garantoj mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut si e tillë në Kosovë dhe se një barrë e pamundur apo joproporcionale [...] nuk mund t’i imponohet Misionit” (shih 2012-19 & 20, [H dhe G kundër EULEX-it](#), 30 shtator 2013, në par. 41, 2012-09, 10, 11 & 12, [A, B, C & D kundër EULEX-it](#), 20 qershor 2013 në par. 50 dhe 2012-16, [Kahrs kundër EULEX-it](#), 10 prill 2013 në par. 30).

57. Sidoqoftë, Paneli vëren se është detyrim i EULEX-it në bazë të Veprimit të Përbashkët të Këshillit për të siguruar që aktivitetet e veta duhet të kryhen në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (shih nenin 3 (i), Këshillin e Përbashkët të Veprimit 2008/124/CFSP; shih paragrafin 25 më lartë, po ashtu krahasoni 2012-19 & 20, H dhe G kundër EULEX-it, 30 shtator 2013, në par. 42).
58. Paneli si rrjedhojë do të vlerësojë nëse në rrethanat e kësaj lënde, EULEX-it në kuadër të kompetencave dhe mjeteve të tij të kufizuara ekzekutive ka qenë në përputhje me detyrimin e tij për t’i siguruar parashtuesit të ankesës zgjidhje juridike në përputhje me nenet 8 dhe 13 të KEDNj-së.

**iii. Detyrimi i EULEX-it që të sigurojë një mjet efektiv për shkeljet e të drejtave që i ngarkohen EULEX-it**

59. Paneli përsërit qasjen e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtutjeshëm “Gjykata”) sipas të cilit “Neni 13 thotë që çdo individ, të cilit iu kanë “shkelur” të drejtat dhe liritë e Konventës duhet të ketë një zgjidhje efektive përpara një instance shtetërore, edhe atëherë kur “shkeljet janë kryer” nga persona që ushtrojnë funksione zyrtare. Kjo dispozitë, lexo siç shkruhet, duket që thotë se një person ka të drejtë në zgjidhje efektive nga shteti vetëm nëse ka ndodhur ndonjë “shkelje”. Megjithatë, personi nuk mund të vërtetojë “shkeljen” përpara ndonjë instance shtetërore, përveç nëse ai së pari është në gjendje të parashtrij tek një autoritet i tillë një ankesë për atë qëllim. Si pasojë, (...) nuk mund të jetë parakusht për zbatimin e nenit 13 që Konventa në fakt të shkelet. Sipas mendimit të Gjykatës, neni 13 kërkon që kur një individ e konsideron veten se ka qenë i dëmtuar nga një masë që dyshohet se shkel Konventën, ai duhet të bëjë një ankim përpara një instance shtetërore në mënyrë që të vendoset rreth kërkesës së tij dhe nëse është e përshtatshme po ashtu edhe të merr dëmshpërblim (shih *Klass kundër Gjermanisë*, nr. 5029/71, aktgjykimi i datës 6 shtator 1978, në paragrafin 64).
60. Gjykata ka deklaruar se “efekti i nenit 13 pra është që të kërkojë ofrimin e një [...] zgjidhje efektive për t’u marrë me substancën e “një ankesë të argumentuar” sipas Konventës dhe për të dhënë ndihmë të përshtatshme (në mesin e shumë autoritetet e tjera, shih *Kudla kundër Polonisë*, nr. 30210/96, aktgjykimi i datës 26 tetorit 2000, në paragrafin 157). Paneli përdor këtë qasje për qëllimet e kësaj lënde.

#### iv. “Argumentueshmëria e një ankese

61. Fakti që EULEX-i ushtron kompetenca të caktuara ekzekutive bart mundësinë që ushtrimi i kompetencave të tilla të mund të rezultojë në shkelje të të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër, kjo ngrit çështjen e të pasurit të një ndihmë të përshtatshëm për ta korrigjuar një shkelje të tillë
62. Gjykata ka pranuar se e drejta për ndihmë do të ekzistonte aty ku kërkesa e viktimës është e “argumentueshme” (midis shumë autoriteteve të tjera shih *Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 5947/72, aktgjykimi i datës 25 mars 1983 në paragrafin 113; *Boyle dhe Rajs kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 27 prill 1988, § 52, Seria A nr. 131).
63. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se në rastin në fjalë në asnjë fazë të procedurës nuk është kontestuar se më 7 qershor 2011 ankuesi iu ishte nënshtruar një sulmi fizik nga një zyrtar policor në uniformë i EULEX-it, i cili pas një grindje verbale kishte vozitur me makinën e tij drejt këmbës së saj. As nuk është kontestuar se ankuesja kishte pësuar lëndim, se ishte shtrirë në spital menjëherë pas incidentit dhe se nuk ishte në gjendje që të punonte për një periudhë kohore. Duke pasur parasysh ndikimin e pakontestueshme që incidenti kishte në jetën e ankueses, Paneli konsideron se ankesa e saj përbën një pretendim të argumentueshëm.
64. Paneli tashmë ka deklaruar në vendimin e tij të pranueshmërisë se detyra e tij ishte “që mos ta gjykoj nëse sjellja e keqe e policit mund t’i ngarkohet EULEX-it. Përkundrazi, ishte thirrur për të përcaktuar nëse, në rrethanat e rastit dhe për qëllimet e ushtrimit efektiv të mandatit ekzekutiv të tij, EULEX-i ishte i obliguar që të siguronte mënyrat e duhura ligjore me qëllim që të siguronte dëmshpërblim të përshtatshëm dhe kështu të përmbushte detyrimet ndaj të drejtave të njeriut sipas neneve 8 dhe 13 të KEDNj-së” (shih 2012-14, [Zahiti kundër EULEX-it](#), 7 korrik 2013, në paragrafin 40). Paneli është mjaft i vetëdijshëm se nocioni i një zgjidhjeje efektive kur zbatohet në kontekst të një misioni të udhëhequr nga një organizatë ndërkombëtare nuk mund të interpretohet në të njëjtën mënyrë si në kontekstin e një shteti. Megjithatë, ka nevojë për të vlerësuar, duke pasur parasysh specifikat e situatës ligjore të EULEX-it, nëse ai gëzonte imunitet dhe rastet kundër zyrtarëve të tij nuk do të mund të ndiqen drejtpërdrejtë para gjykatave të Kosovës, nëse ajo ka adresuar situatën e ankueses në një mënyrë që përputhet së paku me kërkesat minimale procedurale në përputhje me nocionin e një zgjidhjeje efektive.

#### v. Një zgjidhje efektive lidhur me EULEX-in

65. Ankuesja pohon se ajo ishte përpjekur të ndiqte kërkesën e saj nëpërmjet sistemit gjyqësor të Kosovës, mirëpo ishte këshilluar se ankesa e saj nuk mund të ndiqen nëpërmjet procedurave penale ose

civile për shkak të imunitetit të anëtarit përkatës në Kosovë. Si pasojë ajo u ankua në Panel.

***Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut si mënyrë e ndihmës për ankuesen***

66. Përmendja e ekzistencës së Panelit nga EULEX-i në këtë kontekst është pa bazë. Së pari, EULEX-i mban përgjegjësinë e vet për të siguruar një zgjidhje efektive për shkeljen e të drejtave që i ngarkohen misionit. Vendosja e vet përgjegjësisë së EULEX-it që të sigurojë një zgjidhje të tillë efektive në Panel nuk do të ishte në përputhje me mandatin dhe obligimin e EULEX-it për të përmbushur detyrimin e vet për të drejtat e njeriut në përmbushjen e mandatit të tij ekzekutiv. Së dyti, Paneli nuk ka të drejtë të urdhërojë ose të rekomandojë dëmshpërblim financiar edhe kur në rastin e kundërt kjo do të ishte e duhur (shih shtojcën J të OPLAN të EULEX-it). Prandaj, kur kjo formë apo ky dëmshpërblim do të ishte i duhur, Paneli nuk do t'i kishte në dispozicion për ankuesin.

***Mundësia e pagesës së kompensimit***

67. EULEX-i pohon se ankuesja mund t'i drejtohet me kërkesë Sigurimit të Përgjegjësisë ndaj Palës së Tretë. Ajo nuk kishte marrë pjesë në kuadër të procedurës së brendshme disiplinore të EULEX-it, kështu që ajo nuk kishte të drejtë të dëgjohej apo të informohej rreth rezultatit të tyre. Përveç kësaj, EULEX-i i referohet autoriteteve shtetërore të zyrtarit të përfshirë në incident, megjithatë duke vënë në dukje se EULEX-i nuk është në pozitë të hyjë drejtpërdrejtë në diskutime me këto autoritete. Këto argumente do të merren parasysh njëra pas tjetrës.

68. Duket se EULEX-i sugjeron që ankuesja është dashur të kërkonte kompensim qoftë nga EULEX-i apo drejtpërdrejtë nga zyrtari në fjalë.

69. Paneli vëren se EULEX-i nëpër të gjitha parashtresat e tij ka marrë qëndrim se nuk është përgjegjës për lëndimin shkaktuar ankueses. Në këtë kuptim, Paneli nuk mund të sheh se si një kërkesë tek EULEX-i për kompensim, për diçka që e mohon se është përgjegjës mund të konsiderohet si një zgjidhje efektive, të cilën ankuesja në mënyrë të arsyeshme duhet të pritët ta ndjek.

70. Megjithatë, nëse ShM duhet të konsiderojë dhënien e kompensimit ankueses, Paneli vëren se kjo do ta zgjidhë këtë çështje. Sidoqoftë, Paneli vetë nuk është i autorizuar për të rekomanduar kompensim me para atëherë kur konstatohet se është bërë shkelje e të drejtave të njeriut. Paneli mund të bëjë vetëm rekomandime që të ndërmerren veprime korigjuese nga Misioni (Rregulla 34 e rregullores së punës së Panelit).

### **Procedurat e EULEX-it në lidhje me kërkesat e palës së tretë**

71. Në këtë kontekst, Paneli rithekson vërejtjen e Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës se “*në parim, restitutio in integrum është mënyra më e përshtatshme për korrigjimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Mundësia e PSHDNj-së që të rekomandojë veprime korrigjuese duke hequr efektet dhe shkaqet e shkeljes për këtë arsye është e rëndësishme. Megjithatë, në disa raste zgjidhja më efektive është kompensimi financiar, të cilin përkundrazi, PSHDNj-ja nuk mund ta rekomandojë. Në raste të tilla do të jetë e mundur që të kërkohet kompensim financiar, të paktën për dëmin material, në bazë të Policës së Sigurimeve të Përgjegjësive ndaj Palës së Tretë të EULEX-it. Sidoqoftë, Komisioni i Venedikut thekson se procedura në bazë të policës së sigurimit nuk duhet të zgjat tepër apo të jetë e ndërlikuar. Aty vihet në dukje në lidhje me këtë se shefi i Misionit të EULEX-it është zotuar vetë që të rishikoj procedurat e sigurimit për të siguruar që ato të mbeten në fuqi*” (shih Komisionin Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit, [Opinion nr. 545/2009](#), 21 dhjetor 2010, në par. 67).
72. EULEX-i tregon rreth shqyrtimit të kërkesave të palës së tretë që dalin në lidhje me operacionet e tij (shih paragrafët 42 dhe 67). Në këtë drejtim, ShM është i siguruar nga polica gjithëpërfshirëse, mbulimi i së cilës përfshin kërkesat e përgjegjësive ndaj palëve të treta. Përderisa një procedurë e tillë mund të rezultojë në kompensim për dëmshpërbllim financiar, Paneli vëren se në lidhje me këtë misioni deri më tani nuk ka marrë në konsideratë që t'i ofrohet ndonjë kompensim ankuses (shih par. 35 më sipër).

### **Hetimet e brendshme**

#### **Pozita e ankuesit në hetimet e brendshme të EULEX-it**

73. Në kundërshtim me parashtrimet e EULEX-it se një hetim i brendshëm kufizohet në personin që i nënshtrohet hetimit, menaxherit të cilit i raporton dhe autoriteteve përkatëse shtetërore (shih par. 33 më lartë), Paneli vëren se Kodi i Sjelljes si dhe dispozitat përkatëse kërkojnë që vendimet e caktuara që kishin të bënin me hetimet paraprake, procedurat hetimore dhe këshillin disiplinor duhet t'i komunikoheshin ankuses dhe në rastin e viktimës, e cila mund t'i kundërshtoj vendimet e tilla dhe të ketë në një fazë të caktuar të drejtën t'i qaset materialeve në dosjen e lëndës. Prandaj, hetimet e brendshme në dispozicion në kuadër të Misionit japin të drejta të caktuara procedurale për viktimat e sjelljes së papërshtatshme të dyshuar nga pjesëtarët e EULEX-it. Për më tepër, rregulla nuk ndalon apo përjashton mundësinë që, atëherë kur situata e bën të nevojshme, informata të mund t'i ofrohet ankuses.
74. Paneli vëren se në rastin e hetimeve të brendshme kundër një anëtar i stafit të EULEX-it rreth përgjegjësive së këtij të fundit në lidhje me një sulm të dyshuar kundër një zyrtari të policisë së Kosovës do të kishte qenë vendimtare që të intervistohesh viktimat e supozuar rreth incidentit në mënyrë që versioni i saj i ngjarjeve të mund të krahasohej me atë të

kryesit të dyshuar. Kështu që informacioni që do të merrej do të ishte i rëndësishëm drejtpërsëdrejti për vlerësimin nëse ishte e arsyeshme që të ndërpritej çështja pas largimit të anëtarit nga Misioni.

75. Paneli është i vetëdijshëm se EULEX-i është përpjekur të vendos kontakt një herë me ankuesen (shih par. 13 më sipër). Megjithatë, Paneli vë në dukje se ai nuk ka ndërmarrë ndonjë hap tjetër, që në mënyrë të arsyeshme do të mund të kishin qenë të pritshme, me qëllim të marrjes së informatave përkatëse nga ankuesja. Pasi që Misioni ishte menjëherë në dijeni për incidentin, EULEX-i do të mund të pritej që t'i ripërtërinte përpjekjet e veta për ta marrë një deklaratë prej saj. Asnjë arsye bindëse rreth dështimit që të vërtetoheshin rrethanat nuk ishte paraqitur. Për ta përmbledhur, ankueses nuk iu ishte dhënë mundësia për t'u dëgjuar.

### **Hetimet e brendshme si një zgjidhje e përshtatshëm juridike**

76. Nuk është e nevojshme për Panelin që në rrethanat e lëndës në fjalë të marrë ndonjë qëndrim nëse hetimet e brendshme të EULEX-it do të mund të thuhet se përbëjnë “zgjidhje efektive” aty ku dyshimi për shkelje të të drejtave të njeriut është në rrezik. Ai në këtë drejtim vë në dukje vetëm se rregullat në fuqi nuk janë të “pavarura” nga EULEX-i dhe se nuk është treguar se ajo drejtpërdrejtë mund të çojë që viktimës t'i ofrohet kompensim, se nuk mund të jap vendime detyruese dhe e lë vendimin përfundimtar për zbatimin e masës disiplinore në të vendoset nga ShM. Në secilin rast, në lëndën në fjalë aplikantës nuk iu është dhënë mundësia për të marrë pjesë në hetimin e brendshëm në ndonjë rol procedural.
77. Më tutje është vënë re se hetimi i brendshëm në këtë lëndë ka nxjerrë në përfundim se në fakt nuk kishte ndodhur shkelje e kodit të mirësjelljes (shih par. 16 më lartë dhe 2012-14, [Zahiti kundër EULEX-it](#), 7 qershor 2013 par. 27). Në procedurat pranë Panelit, EULEX-i nuk ka parashtruar asnjë argument në mënyrë që të demonstroj, në ato rrethana, se ka qenë në përputhje me të drejtat e ankuesit që ajo të braktis hetimin pa dhënien e ndonjë vendimi formal dhe në këtë mënyrë ia mohon asaj mundësinë që të kërkoj dëmshpërblim. As nuk është shpjeguar në mënyrë të kënaqshme se pse nuk është marrë parasysh mundësia e heqjes së imunitetit të anëtarit të stafit.
78. Më tutje, Paneli vëren se nuk është treguar se as edhe kodi i mirësjelljes në fuqi në atë kohë, e as kodi i tanishëm i sjelljes kanë ofruar bazë ligjore për mbylljen e një hetimi lidhur me rastin për shkak të riatdhesimit të anëtarit të stafit. Këto instrumente ofrojnë një mundësi të tillë *vetëm* për raste që duket se nuk janë në mënyrë të mjaftueshme të vërtetuara. Nuk është argumentuar e lerë më treguar se akuzat e ankueses ishin të pabazuara.
79. Për më tepër, Paneli pranon se që nga momenti i riatdhesimit të personave, ata nuk vazhdojnë të jenë anëtarë të stafit të EULEX-it. Megjithatë, kjo nuk e liron Misionin nga detyrimet e tij lidhur me



llogaridhënien ndaj të drejtave të njeriut. Largimi i anëtarit të stafit nuk i ka dhënë fund detyrimit të Misionit për të respektuar të drejtat e njeriut dhe për të vepruar në përputhje me to. I mbetet EULEX-it për të vendosur se çfarë masash i ka në dispozicion për situata të tilla. Në rastin në fjalë, EULEX-it as nuk i ka kontaktuar Shërbimet EEAS me qëllim që të vendos lidhje përmes tyre me autoritetet e shtetit dërgues, qoftë vetëm sa për të siguruar se sjellja e anëtarit të stafit duhet të regjistrohet siç duhet për vlerësimin e tij profesional dhe EULEX-i nuk ka demonstruar as në procedurat para Panelit se kishte paraparë të vepronte ashtu.

#### vi. Mungesa e zgjidhjeve efektive

80. Çfarë zgjidhje efektive mund t'i mbetet ankueses (domethënë, për t'u përpjekur që të dërgohet lënda e saj jashtë Kosovës tek autoritetet kompetente shtetërore të anëtarit të stafit të EULEX-it në fjalë) në mënyrë të qartë do të ishte shumë e vështirë dhe e pasigurt që të karakterizohet si "efektive", në këto rrethana. Për më tepër, duke pasur parasysh se një "zgjidhje" bie ekskluzivisht në juridiksionin dhe kompetencën e autoriteteve shtetërore, kjo nuk mund të thuhet se shërben si zgjidhje efektive kur bëhet fjalë për veprimet dhe përgjegjësinë e vetë EULEX-it. Në këtë aspekt, Paneli thekson se nenin 10 i Veprimit të Përbashkët nuk mund të interpretohet që shteti që dërgon një anëtar të stafit merr përsipër përgjegjësinë institucionale të EULEX-it për shkeljet e të drejtave të njeriut ( krahasoni Par. 23 dhe 35 më lartë).
81. Prandaj, Paneli konkludon se në rrethanat e këtij rasti, EULEX-i ka shkelur të drejtën e ankueses për zgjidhje efektive, siç është e garantuar *ndër të tjera* sipas nenit 13 të KEDNj-së, ku i mundëson asaj që të kërkoj dëmshpërblim për dëmin që ju është shkaktuar asaj nga një anëtar i stafit të EULEX-it.
82. Së fundi, lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 8 të KEDNj-së, Paneli ka gjetur se veprimet e anëtarit të stafit të EULEX-it *si të tilla* nuk e kanë shkelur nenin 8 të marrë vetë pasi vepra në fjalë nuk ka lidhje të ngushtë të mjaftueshme me funksionin zyrtar të zyrtarit policor të EULEX-it.

#### PËR KËTO ARSYE, PANELI ME SHUMICËN E VOTAVE

1. **Konstaton se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut,**
2. **Konstaton se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut,**
3. **Gjen të përshtatshme, në bazë të gjetjeve të mësipërme të fakteve dhe ligjit, të bëj rekomandimet e mëposhtme për ShM sipas rregullës 34 të rregullores së punës:**



- i. ShM duhet të pranoj se të drejtat e ankueses janë shkelur nga EULEX-i. Paneli fton ShM të njoftoj ankuesen për qëndrimin e vet lidhur me atë pikë;
- ii. ShM duhet të merr parasysh heqjen e imunitetit të ish anëtarit të stafit dhe të informoj prokurorin vendor të Kosovës në përputhje me rrethanat;
- iii. Nëse është e nevojshme përmes EEAS (Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm), ShM duhet të informoj autoritetet shtetërore të shtetit dërgues rreth gjetjeve të Panelit;
- iv. Duke marrë parasysh parashtrimet nga ShM lidhur me disponueshmërinë që ka ankuesja në kërkesat ndaj palës së tretë dhe nëse ShM konsideron që këtij rasti mund t'i ofrohet zgjidhja në atë skemë, Paneli rekomandon se ShM duhet të ftojë ankuesen që të paraqesë një kërkesë tek ajo skemë.

ShM ftohet të njoftoj Panelin rreth masave që ai i ka ndërmarrë në lidhje me vendimin e sotme deri më 15 mars 2014.

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese